

# **STATUTI I SHOQATES**

## **“UNIONI I GAZETAREVE SHQIPTARE”**

### **I. PARIME TE PERGJITHSHME**

#### **KRIJIMI**

##### **Neni 1**

Ne baze te Ligjit Nr.8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese”, Ligjit Nr.8789 date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese” dhe nenit 39 e vijues te Kodit Civil, anetaret themelues: Z.Aleksander Çipa, Znj.Anila Rama, Z.Erion Tase, Z.Fatos Puto, Z.Fatos Baxhaku, Z.Besim Dybeli, Z.Gezim Hashimi, Znj.Entela Komnino, Znj.Rudina Kurti, Znj.Eglantina Nasi, Z.Genc Ymeraj, Z.Jonuz Hallaci, pasi u mblodhen me date 17.10.2005, vendosen bashkarisht, me vullnetin e tyre te lire e te plote, te themelojne Shoqaten “Unioni i Gazetareve Shqiptare”, me incicialet “UGSH”.

##### **Neni 2**

Shoqata “Unioni i Gazetareve Shqiptare”, do te jete jo politike, jo fetare,jo fitimpruese dhe do te ushtroje veprimtarine e saj pa afat, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform statutit dhe programit te saj.

##### **Neni 3**

Shoqata “Unioni i Gazetareve Shqiptare” eshte krijuar per te mbeshtetur komunitetin e gazetareve ne Shqiperi dhe jashte saj, ne cdo vend ku banojne dhe ushtrojne aktivitetin e tyre gazetar.

## **S E L I A**

### **Neni 4**

Shoqata do te kete seline e saj ne Tirane ne Rr.”Gjin Bue Shpata”, Vila Nr.8, porse dhe do te kete dhe dege ne qytetet brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise.

## **QELLIMI**

### **Neni 5**

Qellimi i shoqates eshte: mbrojtja e te drejtave te gazetareve, duke perfshire ketu gazetaret e medias se shkruar dhe asaj elektronike.

Ne permbushje te qellimit te saj shoqata ka synime dhe perparesi te punes se saj:

- a-Monitorimin e vazhdueshem te tregut te punes ne sektorin e mediave.
- b-Monitorimi i kushteve social-ekonomike dhe implementimi i specifikave perkatese ne kontratat kolektive apo dhe individuale mes punedhenesve dhe punemarresve.
- c-Negocime te herepashershme me te tretet per realizimin e permbushjes se detyrimeve perkatese mes paleve respektive.
- d-Perfaqesim ne nivel insitucional perpara subjekteve shteterore dhe atyre private, ne mbrojtje te te drejtave te gazetareve.
- e-Perfaqesim dhe zgjidhje e ceshtjeve perkatese, ne rruge administrative dhe gjyqesore, ne favor te anetareve te shoqates.
- f-Miratimi dhe zbatimi i Kodit te Etikes dhe Pergjegjesise profesionale.
- g-Kryerja e aktiviteve ne nivel kombetar dhe rajonal, per te sensibilizuar komunitetin ne teresi dhe ate te gazetareve ne vecanti.
- h-Aplikime per grante te ndryshme, te cilat do te mundesojne perfshirjen e anetareve te ndryshem ne projekte te caktuara dhe sigurimin e fondeve te perkatese si dhe arritjen e eksperiencave te mundshme.
- i-Kryerja e studimeve te cilat do te mundesojne rritjen e nivelit profesional te anetareve te shoqates.
- j-Publikimi i studimeve te ndryshme te cilat kane lidhje me tregun mediatik te punes.
- k-Bashkepunim me shoqatat homologe brenda dhe jashte vendit.

Si dhe kryerjen e cdo aktiviteti apo siper marrje te ligjshme te cilat do te konsiderohen dhe do te konsistojne efikase ne permbushjen e qellimit dhe objektivave te pritshme te shoqates.

## **KOHEZGJATJA**

### **Neni 5**

Shoqata themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj pa afat, afat qe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqates si person juridik prane Gjykates se shkalles se pare Tirane. Per shkaqe objektive ose shfaqjen e forcave madhore te caktuara, shoqata mund te mbylle aktivitetin e saj, duke respektuar ne kete rast dispozitat perkatese te ligjit shqiptar ne fuqi.

Viti shoqeror fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 dhjetor

### **Neni 6**

Shoqata ka vulen dhe stemen e saj ne te cilat do te vendosen incialet, emri dhe simboli i saj.

## **BURIMET FINANCIARE TE SHOQATES**

### **Neni 7**

Fondet baze te Shoqates do te krijohen nepermjet kuotizacioneve te anetareve te saj, (mase e cila eshte caktuar te jete ne masen 200 leke), aplikimet per fonde, kontributet e donatoreve te ndryshem, apo te ardhurave te tjera qe shoqatat do te siguroje nga burime te tjera te ligjshme, fonde qe do te perdoren ne funksion te permbushjes se qellimit te saj.

## **Neni 8**

Ky Fond do te depozitohet ne nje nga Bankat e qytetit te Tiranes, ndersa shoqata do te kete me pas nje nr.llogarie bankare, ne te cilen do te kryhen me pas te gjitha levizjet e fondeve.

### **ANETARESIMI NE SHOQATE:**

## **Neni 9**

### **KRITERET E PRANIMIT NE SHOQATE:**

Do te pranohen si anetare per te aderuar ne shoqate:

a-Cdo gazetar mbi 18 vjec qe ka punuar per 3 vjet me radhe ne nje organ mediatik.

b-Cdo gazetar qe eshte i gatshem te bashkepunoje apo te punoje ne grup per arritjen e qellimeve perkatese.

c-Cdo gazetar qe eshte i gatshem te permbushe me vullnet detyrimet statutore, te detyrueshme per t'u zbatuar rast pas rasti.

Kerkesa per anetaresim mund te paraqitet me shkrim ne cdo kohe tek Bordi Drejtues e do te miratohet me pas rast pas rasti nga ky i fundit.

### **TE DREJTAT E ANETAREVE TE SHOQATES:**

## **Neni 10**

Anetari i shoqates ka keto te drejta:

- Te zgjedhe dhe te zgjidhet ne organet drejtuese te Shoqates.
- Te jape mendim apo te beje oponence per cdo vendim apo nisme qe merr Shoqata, duke paraqitur me shkrim apo dhe gojarisht variantin e tij.
- T'u kerkoje shpjegime organeve drejtuese per ecurine e platformave te caktuara, ne planin ekzekutiv porse dhe ne ate financiar.

- Te informohet per ecurine e veprimtarise se shoqates ne cdo rast qe do ta konsideroje te nevojshme.
- Te heqe dore nga anetaresia duke njoftuar me shkrim se paku 1 muaj me pare, duke paraqitur nje kerkese me shkrim, Bordit Drejtues te Shoqates.

Te gjithë anetaret e shoqates kane te drejte vote te barabarte ne Mbledhjen e Pergjithshme .

## **DETYRAT E ANETAREVE**

### **Neni 11**

Shoqata eshte e hapur per pranime te reja ne radhet e saj ne çdo kohe sipas kushteve e procedures se rregulluar nga normat e statutit.

Anetari i shoqates ka keto detyra:

- Te respektoje detyrimet statutore
- Te paguaje cdo muaj kutizacionin ne masen 200 leke ne muaj ne fillim te cdo muaji.
- Te respektoje programin dhe rregulloren e shoqates.
- Te perfshihet dhe te jete pjese perberese e grupeve te punes qe do te kujdesen e do te merren direkt me implementimin e platformave dhe strategjive perkatese.

### **Neni 12**

E drejta e antaresise ne shoqate as tjetersohet dhe as trashegohet.

## **PERJASHTIMI NGA SHOQATA:**

### **Neni 13**

Nje anetar i shoqates mund te perjashtohet nga anetaresia ne shoqate kur:

1 - Veprimtaria e kryer prej saj/tij eshte ne kundersizim me etiken dhe detyrimet statutore perkatese.

3 - Figura morale dhe aktiviteti i tij /saj demtojne rende reputacionin e shoqates.

### **Neni 14**

Kerkesa per perjashtim mund te kerkohet nga Keshilli Drejtues, ose nga Mbledhja e Pergjithshme e me pas duhet te miratohet nga 1/3 e antareve te shoqates, me votim te fshehte.

Ne çdo rast vendimi i behet i njohur anetareve te shoqates pas nje periudhe 10 ditore.

### **Neni 15**

Anetari i perjashtuar gezon te drejten e ankimit. Kjo e drejte ushtrohet brenda nje periudhe prej 1 muaji. Ne rast te kundert vendimi i marre ngelet ne fuqi.

Ankimi i drejtohet Mbledhjes se Pergjithshme te Anetareve, e cila eshte e detyruar ta shqyrtoje ate ne mbledhjen e radhes.

Vendimi merret me 2/3 e anetareve te pranishem.

### **Neni 16**

Anetaret qe kane dhene doreheqjen ose qe jane perjashtuar nga shoqata nuk kane te drejta ne kapitalin ose pasurine themelore te shoqates.

## **ANKIMI NE GJYKATE**

### **Neni 17**

Çdo anetar ka te drejte te kundershtojë ne gjykatën kompetente vendimet e shoqates qe vijne ne kundershtrim me ligjin ose me statutin.

Ky kundershtrim mund te behet brenda nje muaji nga dita kur anetari ka marre njoftimin per vendimin perkates.

## **ORGANIZIMI I SHOQATES. ORGANET VENDIMARRESE**

### **Neni 18**

**Organet Drejtuese te Shoqates jane:**

1. Mbledhja e Pergjithshme e Anetareve.
2. Bordi Drejtues
3. Komisioni i Kontrollit Financiar.
4. Kryetari
5. Kryetaret e Degeve te Rretheve

Organi me i larte vendimarrës është Mbledhja e Pergjithshme .

## **TE DREJTAT DHE DETYRAT BAZE**

### **Neni 19**

Organet drejtuese te shoqates kane te drejten dhe detyren themelore te kujdesen per interesat e shoqates, t'i mbrojne ato si dhe te perfaqesojne shoqaten sipas kompetencave qe iu jane dhene nga statuti.

## **MBLEDHJA E PERGJITHSHME E ANETAREVE**

### **Neni 20**

- Organi me i larte drejtues i shoqates eshte MBLEDHJA E PERGJITHSHME E ANETAREVE, e cila eshte caktuar te mblidhet 1 here ne vit, ne seline perkatese.
- Mbledhja e pergjithshme mund te thirret ne raste te vecanta dhe specifike nga Bordi Drejtues i Shoqates ose me kerkesen e 1/5 te anetareve te shoqates.
- Vendimet e saj merren me shumice votash me votim te fshehte.
- Data, vendi, dhe rendi i dites I mbledhjes u komunikohet anetareve te shoqates 15 dite para mbledhjes se caktuar, me rekomande ose fax, duke u konfirmuar rast pas rasti pjesemarrjen e secilit me shkrim.

Mbledhja mund te zhvillohet kur ne te jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te shoqates.

Mbledhja e pergjithshme vendos:

- per ndryshimin e dispozitave te caktuara ne statut.
- percakton strategjine dhe platformen perkatese per vazhdimesine e punes se shoqates.
- mbikeqyr dhe kontrollon realizimin e projekteve dhe detyrave perkatese.
- zgjedh ne cdo 4 vjet Bordin drejtues, kryetarin, sekretarin si dhe komisionin e kontrollit financiar.
- miraton raportin vjetor te punes se shoqates.
- miraton buxhetin dhe shpenzimet per vitin e ardhshem.
- Mbledhja e pergjithshme e anetareve merr vendime me votim te fshehte.
- Vendimet jane te vlefshme n.q.se per to ka votuar me shume se gjysma e anetareve te pranishem.
- Mbledhja e pergjithshme ka kompetence dhe vendos dhe per shperndarjen pse likuidimin e shoqates.

### **Neni 21**

Per ndryshimet ne statut, per perjashtimin e nje anetari ose per shperndarjen e shoqates, kerkohet pjesemarrja dhe miratimi i 2/3 se pjesemarrsesve.

## KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES

### Neni 25

a-Bordi Drejtues zgjidhet ne cdo 4 vjet me votim te fshehte nga Mbledhja e pergjithshme.

b-Bordi Drejtues i Shoqates zgjedh kryetarin e keshillit drejtues, i cili eshte dhe kryetar i shoqates, sekretarin dhe nje pergjegjes per financen.

c-Mbledhjet e Bordit drejtues jane te vlefshme kur ne te jane te pranishem me shume se ½ e tyre (Quorumi).

d- Vendimet merren me shumice votash, me votim te fshehte.

Bordi Drejtues ka keto kompetenca:

1. Te beje propozimet e duhura rast pas rasti per ndryshimet ne statut..
2. Te analizoje veprimtarine e shoqates dhe te organeve te saj drejtuese ndermjet dy mbledhjeve te saj.
3. Te miratoje programin per periudhen ne vazhdim duke caktuar detyrat perkatese per organet drejtuese te shoqates.
4. Te shqyrtoje raportin mbi perdorimin e te ardhurave dhe objekteve pasurore te shoqates duke caktuar edhe detyrimet perkatese per anetaret e Bordit Drejtues.
5. Te propozoje per perjashtimin e anetareve te shoqates si dhe te pranoje perfshirjen e anetareve te rinj ne te, te sugjeroje dhe propozoje ne se do te jete e nevojshme dhe per shperndarjen e shoqates.
6. Merr ne shqyrtim dhe vendos per propozime bashkepunimi e ndihme te ndersjellte mes shoqatave homologe.

Ne rastet e largimit nga detyra si Anetar i Bordit, perpara perfundimit te mandatit perkates, Kryetari ka per detyre te therrase Mbledhjen e Pergjithshme, brenda 30 diteve, duke mundesuar keshtu zgjidhjen e nje anetari te ri, i cili qendron ne kete pozicion deri ne perfundim te mandatit perkates.

## **KOMPETENCAT E KRYETARIT**

### **Neni 26**

1. Drejton veprimtarine e Shoqates dhe kujdeset per mbarevajtjen e puneve te saj.
2. Administron fondet duke iu referuar vendimeve te Keshillit Drejtues.
3. Kontrakton ne cdo rast me te tretet, duke perfaqesuar shoqaten ne nivel insitucional.
4. Duke iu permbajtur strategjive perkatese, te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme vendos per menyren e realizimit te ketyre te fundit.
5. Percakton prioritetet per projektet dhe financimin e tyre.
6. Percakton rregulla per mbarevajtjen e puneve te Shoqates dhe mbikeqyr rast pas rasti zbatimin e tyre.
7. Percakton dhe kontrakton me te trete, duke vendosur dhe angazhimin e specialisteve te ndryshem per ceshtje specifike duke percaktuar ne cdo rast dhe modalitetet perkatese.
8. Pergatit se bashku me Bordin drejtues platformat per mbledhjen e pergjithshme.
9. Drejton mbledhjet e Kryesise dhe Mbledhjes se Pergjithshme dhe kontrollon zbatimin e vendimeve te dala prej saj.
10. Kryen cdo veprim te lejuar nga ligji, porse dhe ne rastet kur autorizohet nga Mbledhja e pergjithshme ne funksion te permbushjes se qellimit te shoqates.

## **KOMPETENCAT E KOMISIONIT TE KONTROLLIT FINANCIAR**

### **Neni 27**

Komisioni i Kontrollit Ekonomik e Financiar ka te drejten e kontrollit per aktivitetin financiar te kryer nga ana e BD.

Per çdo parregullsi qe bie ndesh me Statutin, Programet dhe Rregulloret e miratuara nga organet drejtuese ose nga marreveshjet me donatoret ky Komision ka te drejte te paraqese nje kerkese per rivleresim.

Kerkesa behet me shkrim dhe duhet shqyrtuar ne mbledhjen e radhes. Ne analizen perkatese eshte e detyrueshme prania e nje perfaqesuesi te KKE-se.

Kur komisioni gjykon se vendimi i marre eshte i parregullt dhe cenon rende parimet e shoqates ai mund te kerkoje edhe thirrjen e Mbledhjes se pergjithshme te jashtezakonshme te anetareve te shoqates.

*Gjithashtu ai ka te drejte:*

1. Te percaktoje strategjine e kontrollit rast pas rasti, duke patur te drejten e investigimit te dokumentave te kontabilitetit te shoqates.

2. Te ndaloje shperndarjen e fitimeve midis anetareve te shoqates.

3. Te vezhgoje administrimin e aktiveve dhe pasiveve te shoqates si dhe te siguroje standarte te pranueshme dhe korrekte te praktikave te kontabilitetit.

## **DREJTIMI**

### **Neni 28**

Mbledhja e Pergjithshme zgjedh Bordin Drejtues me nje mandat 4-vjecar me te drejte rizgjedhje .

Mbledhja e pare e Pergjithshme zgjodhi Bordin Drejtues, i cili perbehet nga 5 anetare:

-Aleksander Cipa

-Entela Komnino

-Fatos Baxhaku

-Anila Rama

-Besim Dybeli

Bordi Drejtues pasi terhiqet per vendim,me votim te fshehte zgjedh kryetar te saj Z.Aleksander Cipa.

Mbledhja e pergjithshme zgjedh me votim te fshehte dhe Sekretarin e saj,Z.Genc Ymeraj.

Bordi Drejtues do te mblidhet cdo 3-muaj dhe do te analizoje veprimtarine e shoqates

## **DOREHEQJA**

### **Neni 29**

Çdo anetar i Bordit Drejtues mund te deklaroje doreheqjen e tij ne çdo kohe nepermjet nje kerkese me shkrim te paraqitur jo me pak se 3 (tre) muaj para.

## **PERGJEGJESIA E DREJTUESVE**

### **Neni 29**

Çdo drejtues i shoqates gjate ushtrimit te mandatit tij, eshte i detyruar te kryeje te gjitha veprimet ne interes te shoqates ne perputhje e zbatim te normave te statutit si dhe veprimeve e orientimeve te Mbledhjes se Pergjithshme.

## **ADMINISTRIMI I PASURISE**

### **Neni 30**

Shoqata ka te drejte ta administroje pasurine e saj te luajtshme e te palujtshme, te lidhe kontrata me te trete ne funksion te realizimit te qellimeve te saj, ndersa vlerat e perfutuara ne kete rast, duhet qe ne cdo rast t'i kalojne buxhetit te Shoqates.

## **SHPERNDARJA**

### **Neni 31**

Shoqata mund te shperndahet per keto shkaqe kryesore:

- a. Kur numri i anetareve te saj ka mberritur nen minimumin e caktuar ne ligj ne nenin 24/2 te ligji 8788 dt 07.05 2001, pra nen 5-anetare.
- b. Kur qellimi i saj eshte permbushur apo nuk ka mundesi te permbushet.
- c. Kur shoqata eshte larguar nga qellimi i caktuar ne statut.
- d. Kur ajo ka filluar te kryeje veprimtari te kundraligjshme e ne raste te tjera te percaktuara nga neni 44 e vijues te ligjit 8788.
- e. Me vendim te mbledhjes se pergjithshme te thirrur nga Keshilli Drejtues.

## **E DREJTA E SHPERNDARJES**

### **Neni 32**

Shperndarja e shoqates behet:

- a. Me vendim te Mbledhjes se Pergjithshme te thirrur posacerisht.
- b. Me vendim te gjykates kompetente.

## **LIKUIDIMI**

### **Neni 33**

Kur vendoset shperndarja e shoqates ajo çregjistrohet, pushon veprimtarine e saj dhe vihet ne likuidim nga komisioni i likuidimit, i cili formohet dhe vepron sipas ligjeve e rregullave ne fuqi.

## **MOSMARREVESHJET**

### **Neni 34**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet anetareve te shoqates dhe organeve te saj, ndermjet shoqates dhe personave te trete do te zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e shkalles se pare Tirane.

## **DISPOZITA TE FUNDIT**

### **Neni 35**

Per c'ka nuk eshte shprehur ne kete statut, me pas do jene reference e do te zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe ne menyre te veçante dispozita e Kodit Civil, Kreu II, Pika B. Shoqata si dhe ligji 8788 dt 07.05.2001.

### **Neni 36**

Ky statut, pasi lexohet e shqyrtohet nga ne, hartuesit e tij, bashkethemelues te kesaj shoqate dhe gjendet ne pajtim me vullnetin tone te lire nenshkruhet nga ne me vullnetin tone te lire e te plote.

### **Anetaret e Mbledhjes se Pergjithshme**

**1.Aleksander Cipa**

**2.Entela Komnino**

**3.Anila Rama**

**4.Erion Tase**

**5.Fatos Puto**

**6.Fatos Baxhaku**

**7.Rudina Kurti**

**8.Jonuz Hallaci**

**9.Eglantina Nasi**

**10.Genc Ymeraj**

**11.Besim Dybeli**

**12.Gezim Hashimi**

**perfaqesuar me prokure te posacme nga Aleksander Cipa**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**NOTERIA TIRANE**

**Nr. \_\_\_\_Rep**

**VERTETIM**

Sot me date 18.10.2005 para meje Noteres Luljeta Kongoli, Anetare e Dhomes se Noterise,Tirane, me seli ne Rr “Durrësit”, u paraqit personalisht: Kryetari i Shoqates “Unioni i Gazetareve Shqiptare”, Z.Aleksander Cipa, i biri i Lefterit dhe Qeranes, lindur me 12 janar 1967 ne Himare dhe banues ne Tirane, Rr.”Margarita Tutulani”,Vila Nr.3, madhor me zotesi te plote juridike, i cili u identifikua para meje me pashaporten personale me nr. 0012681. Ai me deklaroi se ky statut eshte redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e lire dhe te plote te Anetareve themelues, ndersa ai me cilesine e perfaqesuesit te tyre ligjor, nenshkruan para meje rregullisht. Ndersa une noterja vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**NOTERE**

## **AKT-THEMELIMI**

### **“UNIONI I GAZETAREVE SHQIPTARE”**

Sot me date 17.10.2005, anetaret themelues Z. Aleksander Cipa, Znj.Anila Rama, Z. Erion Tase, Z. Fatos Puto, Z. Fatos Baxhaku, Z.Besim Dybeli, Z.Gezim Hashimi, Znj. Entela Komnino, Znj. Rudina Kurti, Znj. Eglantina Nasi, Z.Genc Ymeraj, Z. Jonuz Hallaci, pasi u mblodhen me date 17.10.2005, (me identitetin e percaktuar nga pasaportat personale bashkengjitur ketij akti), ne baze te Ligjit Nr.8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese”, Ligjit Nr.8789 date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese” dhe nenit 39 e vijues te Kodit Civil vendosen bashkarisht, me vullnetin e tyre te lire e te plote, te themelojne Shoqaten “Unioni i Gazetareve Shqiptare”, me incialet “UGSH”.

### **STATUSI LIGJOR I SHOQATES**

#### **Neni 1**

Shoqata “Unioni i Gazetareve Shqiptare”,do te jete jo politike, jo fetare, jo fitimpruese dhe do te ushtroje veprimtarine e saj pa afat, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform statutit dhe programit te saj.

#### **SELIA**

#### **Neni 2**

Shoqata do te kete seline e saj,ne Tirane ne Rr.”Gjin Bue Shpata”,Vila Nr.8, si dhe dege ne qytetet brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise.

# QELLIMI

## Neni 3

Qellimi i shoqates eshte: mbrojtja e te drejtave te gazetareve, duke perfshire ketu gazetaret e medias se shkruar apo dhe asaj elektronike.

Ne permbushje te qellimit te saj shoqata ka si synime dhe prioritete te punes se saj:

- Monitorimin e vazhdueshem te tregut te punes ne sektorin e mediave.

- Monitorimi i kushteve social-ekonomike dhe implementimi i specifikave perkatese ne kontratat kolektive apo dhe individuale mes punedhenesve dhe punemarresve.

- Negocime te herepashershme me te tretet per realizimin e permbushjes se detyrimeve perkatese mes paleve respektive.

- Perfaqesim ne nivel insitucional perpara subjekteve shteterore dhe atyre private, ne mbrojtje te te drejtave te gazetareve.

- Perfaqesim dhe zgjidhje e ceshtjeve perkatese,ne rruge administrative porse dhe gjyqesore, ne favor te anetareve te shoqates.

- Miratimi dhe zbatimi i Kodit te Etikes dhe Pergjegjesise profesionale.

- Kryerja e aktiviteteve ne nivel kombetar apo dhe rajonal, per te sensibilizuar komunitetin ne teresi dhe ate te gazetareve ne vecanti.

- Aplikime per grande te ndryshme, te cilat do te mundesojne perfshirjen e anetareve te ndryshem ne projekte te caktuara dhe sigurimin e fondeve te perkatese si dhe arrijten e eksperiencave te mundshme.

- Kryerja e studimeve te cilat do te mundesojne rritjen e nivelit profesional te anetareve te shoqates.

- Publikimi i studimeve te ndryshme te cilat kane lidhje me tregun mediatik te punes.

- Bashkepunim me shoqatat homologe brenda dhe jashte vendit.

Si dhe kryerjen e cdo aktiviteti apo siper marrje te ligjshme te cilat do te konsiderohen dhe do te konsistojne efikase ne permbushjen e qellimit dhe objektive te pritshme te shoqates.

## **KOHEZGJATJA**

### **Neni 4**

Shoqata themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj pa afat, afat i cili do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqates si person juridik prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.

Per shkaqe objektive ose shfaqjen e forcave madhore te caktuara shoqata mund te mbylle aktivitetin e saj, duke respektuar ne kete rast dispozitat perkatese te ligjit shqiptar ne fuqi.

Viti shoqeror fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 dhjetor.

## **BURIMET FINANCIARE TE SHOQATES**

### **Neni 5**

Fondet baze te Shoqates do te krijohen nepermjet kuotizacioneve te anetareve te saj, (mase e cila eshte caktuar te jete ne masen 200 leke), aplikimet per fonde, kontributet e donatoreve te ndryshem, apo te ardhurave te tjera qe shoqatat do te siguroje nga burime te tjera te ligjshme, fonde te cilat do te perdoren ne funksion te permbushjes se qellimit te saj.

## **ORGANET DREJTUESE TE SHOQATES**

### **Neni 6**

6. Mbledhja e Pergjithshme e Anetareve.
7. Bordi Drejtues
8. Komisioni i Kontrollit Financiar.
9. Kryetari
10. Kryetaret e Degeve te Rretheve

Organi me I larte vendimarrës është Mbledhja e Pergjithshme .

## **MBLEDHJA E PERGJITHSHME E ANETAREVE**

### **Neni 7**

Organi me i larte drejtues i shoqates eshte MBLEDHJA E PERGJITHSHME E ANETAREVE, e cila eshte caktuar te mblidhet 1 here ne vit ne seline perkatese.

Mbledhja e pergjithshme mund te thirret ne raste te vecanta dhe specifike nga Bordi Drejtues i Shoqates, ose me kerkesen e 1/5 te anetareve te shoqates.

Vendimet e saj merren me shumice votash me votim te fshehte.

Data, vendi, dhe rendi i dites I mbledhjes u komunikohet anetareve te shoqates 15 dite para mbledhjes se caktuar, me rekomande ose fax, duke u konfirmuar rast pas rasti pjesemarrja e secilit me shkrim.

Mbledhja mund te zhvillohet kur ne te jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te shoqates.

Mbledhja e pergjithshme vendos:

-per ndryshimin e dispozitave te caktuara ne statut.

-percakton strategjine dhe platformen perkatese per vazhdimesine e punes se shoqates.

-mbikeqyr dhe kontrollon realizimin e projekteve dhe detyrave perkatese.

-zgjedh ne cdo 4 vjet Bordin drejtues, kryetarin, sekretarin si dhe komisionin e kontrollit financiar.

-miraton raportin vjetor te punes se shoqates.

-miraton buxhetin dhe shpenzimet per vitin e ardhshem.

Mbledhja e pergjithshme e anetareve merr vendime me votim te fshehte.

Vendimet jane te vlefshme n.q.se per to ka votuar me shume se gjysma e anetareve te pranishem.

Mbledhja e pergjithshme ka kompetence dhe vendos dhe per shperndarjen o se likuidimin e shoqates.

## **Neni 8**

Per ndryshimet ne statut, per perjashtimin e nje anetari ose per shperndarjen e shoqates, kerkohet pjesemarrja dhe miratimi i 2/3 se pjesemarrsesve.

## **KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES**

### **Neni 9**

Bordi Drejtues zgjidhet ne cdo 4 vjet me votim te fshehte nga Mbledhja e Pergjithshme.

Bordi Drejtues i Shoqates zgjedh kryetarin e keshillit drejtues, i cili eshte dhe kryetar i shoqates, sekretarin dhe nje pergjegjes per financen.

Mbledhjet e Bordit drejtues jane te vlefshme kur ne te jane te pranishem me shume se 1/2 e tyre (Quorumi).

Vendimet merren me shumice votash, me votim te fshehte.

Bordi Drejtues ka keto kompetenca:

1. Te beje propozimet e duhura rast pas rasti per ndryshimet ne statut..
2. Te analizoje veprimtarine e shoqates dhe te organeve te saj drejtuese ndermjet dy mbledhjeve te saj.
3. Te miratoje programin per periudhen ne vazhdim duke caktuar detyrat perkatese per organet drejtuese te shoqates.
4. Te shqyrtoje raportin mbi perdorimin e te ardhurave dhe objektive pasurore te shoqates duke caktuar edhe detyrimet perkatese per anetaret e Bordit Drejtues.
5. Te propozoje per perjashtimin e anetareve te shoqates si dhe te pranoje perfshirjen e anetareve te rinj ne te, te sugjeroje dhe propozoje ne se do te jete e nevojshme dhe per shperndarjen e shoqates.
6. Merr ne shqyrtim dhe vendos per propozime bashkepunimi e ndihme te ndersjellte mes shoqatave homologe.

Ne rastet e largimit nga detyra si Anetar i Bordit perpara perfundimit te mandatit perkates, Kryetari ka per detyre te therrase Mbledhjen e Pergjithshme,

brenda 30 diteve, duke mundesuar keshtu zgjedhjen e nje anetari te ri, i cili qendron ne kete pozicion deri ne perfundim te mandatit perkates.

## **KOMPETENCAT E KRYETARIT**

### **Neni 10**

1. Drejton veprimtarine e Shoqates dhe kujdeset per mbarevajtjen e puneve te saj.
2. Administron fondet duke iu referuar vendimeve te Keshillit Drejtues.
3. Kontrakton ne cdo rast me te tretet, duke perfaqesuar shoqaten ne nivel insitucional.
4. Duke iu permbajtur strategjive perkatese, te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme vendos per menyren e realizimit te ketyre te fundit.
5. Percakton prioritetet per projektet dhe financimin e tyre.
6. Percakton rregullaperevajtjen e puneve te Shoqates dhe mbikqyr rast pas rasti zbatimin e tyre.
7. Percakton dhe kontrakton me te trete, duke vendosur dhe angazhimin e specialisteve te ndryshem per ceshtje specifike duke percaktuar ne cdo rast dhe modalitetet perkatese.
8. Pergatit sebashku me Bordin drejtues platformat per mbledhjen e pergjithshme.
9. Drejton mbledhjet e Kryesise dhe Mbledhjes se Pergjithshme dhe kontrollon zbatimin e vendimeve te dala prej saj.
10. Kryen cdo veprim te lejuar nga ligji dhe ne rastet kur autorizohet nga Mbledhja e pergjithshme ne funksion te permbushjes se qellimit te shoqates.

# KOMPETENCAT E KOMISIONIT TE KONTROLLIT FINANCIAR

## Neni 11

Komisioni i Kontrollit Ekonomik e Financiar ka te drejten e kontrollit per aktivitetin financiar te kryer nga ana e BD.

Per çdo parregullsi qe bie ndesh me Statutin, Programet dhe Rregulloret e miratuara nga organet drejtuese ose nga mareveshjet me donatoret ky Komision ka te drejte te paraqese nje kerkeses per rivleresim.

Kerkesa behet me shkrim dhe duhet shqyrtuar ne mbledhjen e radhes.

Ne analizen perkatese eshte e detyrueshme prania e nje perfaqesuesi te KKE-se.

Kur komisioni gjykon se vendimi i marre eshte i parregullt dhe cenon rende parimet e shoqates ai mund te kerkoje edhe thirrjen e Mbledhjes se pergjithshme te jashtezakonshme te anetareve te shoqates.

*Gjithashtu ai ka te drejte:*

1. Te percaktoje strategjine e kontrollit rast pas rasti,duke patur te drejten e investigimit te dokumentave te kontabilitetit te shoqates.
- 2.Te ndaloje shperndarjen e fitimive midis anetareve te shoqates.
- 3.Te vezhgoje administrimin e aktiveve dhe passiveve te shoqates dhe siguroje standarte te pranueshme dhe korrekte te praktikave te kontabilitetit.

## DREJTIMI

### Neni 12

Mbledhja e Pergjithshme zgjedh Bordin Drejtues me nje mandat 4-vjecar me te drejte rizgjedhje .

Mbledhja e pare,zgjodhi Bordin Drejtues i cili perbehet nga 5 anetare:

-Aleksander Cipa

-Entela Komnino

-Fatos Baxhaku

-Anila Rama

-Besim Dybeli

Bordi Drejtues pasi terhiqet per vendim, me votim te fshehte zgjedh kryetar te saj Z.Aleksander Cipa.

Mbledhja e pergjithshme zgjedh me votim te fshehte dhe Sekretarin e saj,Z.Genc Ymeraj.

Bordi Drejtues do te mblidhet cdo 3-muaj dhe do te analizoje veprimtarine e shoqates

### **Anetaret e Mbledhjes se Pergjithshme**

**1.Aleksander Cipa**

**2.Entela Komnino**

**3.Anila Rama**

**4.Erion Tase**

**5.Fatos Puto**

**6.Fatos Baxhaku**

**7.Rudina Kurti**

**8.Jonuz Hallaci**

**9.Eglantina Nasi**

**10.Genc Ymeraj**

**11.Besim Dybeli**

**12.Gezim Hashimi**

**perfaqesuar me prokure te posacme nga Aleksander Cipa**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**NOTERIA TIRANE**

**Nr.\_\_\_\_Rep**

**VERTETIM**

Sot me date 18.10.2005 para meje Noteres Luljeta Kongoli, Anetare e Dhomes se Noterise, Tirane, me seli ne Rr “Durrësit”, u paraqit personalisht: Kryetari i Shoqates “Unioni i Gazetareve Shqiptare”, Z.Aleksander Cipa, i biri i Lefterit dhe Qeranes, lindur me 12 janar 1967 ne Himare dhe banues ne Tirane, Rr.”Margarita Tutulani”, Vila Nr.3, madhor me zotesi te plote juridike, i cili u identifikua para meje me pashaporten personale me nr. 0012681. Ai me deklaroi se ky akt themelimi eshte redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e lire dhe te plote te Anetareve themelues, ndersa ai me cilesine e perfaqesuesit te tyre ligjor, nenshkruan para meje rregullisht. Ndersa une noterja vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**NOTERE**